

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtëmbëdhjetë e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 26.06. 2023

Në mbledhje morën pjesë:

- 1.Mirheta Gaçeviq, kryetare;
- 2.Ivana Krushçiq, anëtare;
- 3.Admir Adroviq, anëtar;
- 4.Tripo Matijeviq, anëtar

Anëtarët Veron Halili dhe Frashër Selimaj nuk morën pjesë në mbledhje për shkaqe të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë e kishin njoftuar kryetaren e Komisionit.

Krahas anëtarëve të cekur të Komisionit, në mbledhje nuk mori pjesë edhe Ivan Lekoviq, sekretar i Komisionit, për shkak të shfrytëzimit të pushimit vjetor.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutim dhe deklarim lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e pesëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit;
2. Komentet në Kontratën për ofrimin e shërbimeve publike nr. 01-2400 të datës 30. 05. 2018, të kontraktuar mes RTMZ dhe Qeverisë së MZ;
3. Analiza e punës së deritashme të Komisionit në aspektin e drejtimit të veprimtarisë me Këshillin dhe menaxhmentin e RTMZ;
4. Të ndryshme

I

Procesverbali nga mbledhja e pesëmbëdhjetë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (4 vota PËR)

II

Mirheta Gaçeviq i njoftoi anëtarët e pranishëm se pas njoftimit me materialin e dorëzuar ka vërejtur se në nenin 5 shkruan se në kuadër të afatit kohorë të kontratës së cekur, RTMZ obligohet që ti plotësojë të gjitha obligimet programore me përmbajtjet e kontraktuara programore. Obligimet programore kanë të bëjnë në mbrojtjen e trashëgimive kulturore të popujve pakicë dhe bashkësive të definuara më qartë me Propozimin e obligimeve programore të RTMZ, si pjesë përbërëse të Kontratës. Gjithashtu është konstatuar se në bazë të analizës të cilën e ka punuar Organizata joqeveritare, "Aleanca qytetare", nuk mund të vihet re skadimi i kontratës me datën 31.12.2020, duke pasur parasysh në periudhën kohore kur është punuar analiza. Ajo propozoi që nga shërbimet kompetente të RTMZ të kërkohet plotësimi i materialit të dorëzuar, respektivisht propozimit i cili përmban obligimet programore të RTMZ. Anëtarët tjerë e përkrahen iniciativën e saj dhe erdhën në përfundim se për këtë ti drejtohen Këshillit të RTMZ.

III

Ivana Krushçiq u shpreh se bashkëpunimi me Këshillin është në nivel të lartë, respektivisht se janë përgjigjur të gjitha kërkesave, iniciativave të Komisionit, gjë që nuk mund të thuhet për menaxhmentin e RTMZ.

Admir Adroviq tha se Komisioni i drejtohet Këshillit, si organ të cilin e ka themeluar, kurse disa çështje të cilat kanë të bëjnë me ta, Këshilli ende i drejtohet menaxhmentit, me kërkesë të Komisionit, gjë që sjellë në përfundim se komunikimi mes Këshillit dhe menaxhmentit nuk është i mirë.

Tripo Matijeviq shprehu qëndrimin e tij se menaxhmenti ju përgjigj ftesave që të marrë pjesë në

mbledhje, për çgjie ceku edhe disa shembuj, siç ishte rasti me Komisionin e mëparshëm, anëtar i të cilit ishte.

Mirheta Gaçeвиq theksoi se konsideron se duhet përmirësuar komunikimin në aspektin e njoftimit të Komisionit para ndryshimeve të shemave programore, respektivisht të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me popujt pakicë dhe bashkësive tjera. Nevojitet që të bëhet praktikë që Komisioni ta ka mundësinë ta paraqes qëndrimin e vet për këto çështje para se Këshilli të sjellë vendim. Gjithashtu konsideron se duhet ndikuar edhe në vet Redaksi që të përmirësojnë përmbajtjet e planeve programore, kurse menaxhmenti të përcjellë se do të realizohen ato.

Admir Adroviq është i mendimit se shumë me rëndësi është të mos ketë ngecje, stagnim, në program dhe se ka bindje se kjo po ndoll. Gjithashtu theksoi se ka pasur disa propozime për emisione të reja ose avancim të atyre ekzistuese nga vetë Redaksia, por ato nuk janë pranuar nga ana e menaxhmentit që konsideron se nuk është praktikë e mirë.

Tripo Matijeвиq theksoi se duhet pasur kujdes kur të propozohet Plani i ri Programor e i Produksionit, në numrin e emisioneve, terminet e emetimeve, sezoneve kur emetohen, respektivisht dinamikën e tyre dhe nëse vjen deri te ndryshimi i termineve për ndonjë arsye, të ndryshohen me termine adekuate.

Admir Adroviq konsideron se ka disa përmirësime, në aspektin se emisioni, “Mostovi” i cili reprizohet dhe tani shikuesit mund ta përcjellin në Programin e parë, në Kanalën parlamentar, në portal etj. Që do të thotë se megjithatë ka lëvizje pozitive. Ai gjithashtu theksoi se ka bashkëpunim korrekt me Këshillin e RTMZ në aspektin se ata reagues në çdo iniciativë të Komisionit, dhe se ky bashkëpunim mund edhe më shumë të përmirësohet, e kjo varet nga anëtarët e Komisionit dhe të punësuarve në Redaksi.

IV

Anëtarët e Komisionit së bashku konstatuan se RTMZ ka bërë lëshim sepse nuk shënoi me asnjë raport 20 qershorin, Ditën e myslimanëve të Malit të Zi. Me këtë rast ishte organizuar manifestim solemn në Bijello Pole, e që nuk është përcjellë në çfarëdo mënyre. Gjithashtu konsiderojnë se data e cekur është Dita ndërkombëtare e refugjatëve, që nuk është më pak me rëndësi por që është përcjellë, dhe se nuk kanë mirëkuptim për këso lëshimesh. Ata konsiderojnë se ky lëshim i duhet cekur Redaksisë e cila nuk e ka kryer punën e vet. Me këtë rast, si dhe për disa çështje tjera të hapura,, do të ftohen në mbledhjen e radhës të Komisionit.

PROCESVERBALIN E PUNOI
Ivan Lekoviq

KRYETARJA E KOMISIONIT
Mirheta Gaçeвиq